



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 659/6 prot.,

Tiranë, më 03.03.2020

VENDIM  
Nr. 17, datë 15.02.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NE VENDIMET E BORDIT TË ADMINISTRIMIT Nr.55, DHE Nr. 56  
DATË 20.12.2019**

Në bazë të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.39, datë 23.01.2019, “Për disa ndryshime në VKM nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”” të ndryshuar,, nenit 51 e vijues të Statutit të UMT-së dhe në materialin e Administratorit të UMT-së nr.197/4 prot., datë 17.02.2020 “Mbi një ndryshim në vendimet e Bordit nr.55, datë 20.12.2019 dhe nr.56, datë 20.12.2019”, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pas diskutimit të tij,

**VENDOSI:**

1. Studenti Ergi Islam Çela, i përfshirë në listat e shpallura për përfitim burse dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, në Vendimet e Bordit të Administrimit nr.55, datë 20.12.2019 “ Për miratimin e listës së studentëve që përfitojnë bursë për vitin akademik 2019-2020, që studiojnë në një program studimi të ciklit të parë...” dhe nr.56, datë 20.12.2019 “Për miratimin e listës së studentëve që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, që studiojnë në një program ...”, i cili nuk figuron student i rregjistruar ne FSHMT-të, të hiqet nga listat e shpallura si student përfitues i bursës dhe përfitues i përjashtimit nga tarifa e shkollimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI  
FLORIAN TOTË

